

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 7077
E premte, 22 dhjetor 2023
Çmimi 0.50 €

"Çohu": 44 për qind e qytetarëve mendojnë se liderët e partive janë të korruptuar | FAQE 5



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

OSMANI DHE KURTI U BËJNË THIRRJE QYTETARËVE T'I RESPEKTOJNË RREGULLAT E LIBERALIZIMIT TË VIZAVE

 | FAQE 4-5

Qytetarët e Kosovës nga 1 janari i vitit 2024 do të mund të udhëtojnë pa viza në 27 shtete të Zonës Shengen deri në 90 ditë brenda periudhës prej 180

ditësh. Ky regjim, megjithatë, bart disa rregulla që duhet të ndiqen, në të kundërtën pason gjoba ose ndalesa e hyrjes. Presidentja Vjosa Osmani dhe

kryeministri Albin Kurti të enjten u kanë bërë thirrje qytetarëve t'i respektojnë të gjitha rregullat që janë pjesë e sistemit të liberalizimit të vizave

AKTUALE



UKRAINA PRANON NDIHMË TË RE FINANCIARE NGA EVROPIANËT | F. 2

APARATURAT PËR DIAGNOSTIKIM OSE NUK PUNOJNË, OSE NUK SHFRYTËZOHEN | F. 5

INSTITUCIONET ZBATOJNË VETËM 20 PËR QIND TË REKOMANDIMEVE TË AVOKATIT TË POPULLIT | F. 7

EKONOMI



KOSOVA GJOBIT MTS-NË ME 1.5 MILION EURO PËR SHKELJE TË LIGJIT TË KONKURRENCËS | F. 8


DEMOKRACIA PLUS: NDËRMARRJET PUBLIKE S'PO I ZBATOJNË PLANET VJETORE TË PROKURIMIT PUBLIK | F. 8

SPORT



RAMADANI, NGA SHITËS I FRUTAVE NË ZBULIMIN E SERISË A | F. 10

KUVENDI I SHOIPËRISË HAP RRUGËN PËR ARRESTIMIN E ISH-KRYEMINISTRIT BERISHA | F. 3



NËNSHKRUHET MARRËVESHJA 6 MILIONË EURO PËR EFIÇIENCË TË ENERGJISË NË NDËRTESA PUBLIKE | F. 6



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVE
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Ukraina pranon ndihmë të re financiare nga evropianët

KIEV, 21 DHJETOR - Kryeministri ukrainas Denys Shmyhal ka thënë se Kievi ka pranuar këstin e fundit prej 1.5 miliard eurosh, prej paketës 18-miliardëshe të ndarë nga Bashkimi Evropian. "Sot kemi pranuar 1.5 miliard eurot e fundit prej paketës financiare 18-miliardëshe. Shpresojmë për një mbështetje të vazhdueshme, të palëkundur nga ana e BE-së", ka thënë Shmyhal në "X".

Ai e ka bërë këtë deklaratë pasi Gjermania ka njoftuar se do të ndajë 88.5 milionë euro shtesë për të ndihmuar në përfundim të sistemit ukrainas të energjisë pas sulmeve ukrainase në këtë infrastrukturë.

Injekcioni i ri financiar vjen teksa pak dihet nëse do të ketë më ndihmë financiare prej Shteteve të Bashkuara, pasi ligjvënësit e Kongresit i kanë përfunduar punimet për këtë vit, pa arritur ndonjë marrëveshje për të ndarë

61 miliardë dollarë për Ukrainën. Presidenti amerikan Joe Biden i ka bërë thirrje Kongresit t'i miratojë fondet për Ukrainën, mirëpo republikanët konservatorë kanë kërkuar më shumë fonde për përfundim të kufijve amerikanë për shkak të rritjes së numrit të migrantëve.

Presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky ka thënë më 19 dhjetor se është i sigurt që Shtetet e Bashkuara do ta mbajnë premtimin për të ndarë miliarda dollarë, që i mundësojnë Kievit ta vazhdojë luftën.

Lufta e Rusisë në Ukrainë, e nisur në shkurt të vitit 2022, mbush dy vjet dhe fundi nuk i shihet.

Më 21 dhjetor ministri ukrainas i Mbrojtjes, Rustem Umerov, u ka thënë medieve të huaja se ushtria ukrainase do të nisë shpejt mobilizimin e burrave prej 25 vjeç deri në 60 që jetojnë jashtë shtetit. Umerov ka thënë se ata që nuk i



lajmërohen thirrjes për mobilizim do të përballen me sanksione të paspecifikuara.

Më 19 dhjetor Zelensky ka thënë se ushtria ukrainase është duke çuar përpara një propozim për mobilizim të 500 000 civilëve, mirëpo ai vetë ende nuk ka vendosur nëse do ta mbështesë thirrjen.

Ukraina nuk ka treguar sa ushtarë janë të angazhuar në luftë, mirëpo në disa raste është përmendur se janë rreth 1 milion njerëz me armë në duar.

Rusia e ka zgjeruar ushtrinë prej nisjes së luftës në Ukrainë, dhe ka thënë se planifikon ta rrisë forcën me 1.5 milion njerëz shtesë.

Presidenti rus Vladimir Putin e

quan luftën "operacion special ushtarak" për ta çmilitarizuar Ukrainën.

Perëndimi është përgjigjur ndaj Rusisë, duke goditur ekonominë e këtij shteti me sanksione të ashpra. Si pasojë e luftës kanë vdekur mijëra persona dhe miliona të tjerë janë zhvendosur nga shtëpitë e tyre.

Vuçiçi pretendon se "një vend i rëndësishëm" ndërhyri në zgjedhjet në Serbi

BEOGRAD, 21 DHJETOR - Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiçi, tha të enjten se autoritetet shtetërore të Serbisë po e hartojnë "një letër të rëndësishme për ndikimin dhe ndërhyrjen e një vendi të rëndësishëm në procesin zgjedhor të Serbisë në mënyrën më brutale". Ai nuk specifikoi se cilit shtet po i referohej. "Do të kryhet deri në Vitin e Ri dhe më pas do ta dërgojmë në mbarë botën që të shihet se si bëhet një ndërhyrje e tillë në procese që i përkasin një vendi të pavarur sovran", tha Vuçiçi të enjten.

Vuçiçi tha, po ashtu, se zgjedhjet e mbajtura më 17 dhjetor "ishin më të pastrat dhe më të drejtat deri më



tani".

Fundjavën e kaluar Serbia mbajti zgjedhje parlamentare, provinciale

dhe lokale.

Koalicioni më i madh opozitar "Serbia kundër dhunës" nuk i njeh

rezultatet e zgjedhjeve dhe kërkon mbajtjen e zgjedhjeve të reja, duke pretenduar se fitorja e Partisë Progresive Serbe (SNS) është rezultat i vjedhjes së votave.

Një ekip vëzhgues ndërkombëtar i përbërë nga anëtarë të Misionit të OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut, Parlamentit Evropian, Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës dhe Asamblesë Parlamentare të OSBE-së, vuri në dukje "parregullsi serioze" gjatë zgjedhjeve në Serbi.

Më 18 dhjetor ata deklaruan se ato zgjedhje u shënuan, ndër të tjera, nga keqpërdorimi i fondeve publike, dominimi mediatik i

presidentit Aleksandar Vuçiçi, një fushatë negative dhe përhapja e frikës.

Pas këtyre vlerësimeve kanë reaguar edhe përfaqësuesi i lartë i BE-së, Josep Borrell dhe komisionari për Zgjerim, Oliver Varhelyi. Më 19 dhjetor ata i bënë thirrje Serbisë ta "përmirësojë ndjeshëm" procesin zgjedhor.

Më 19 dhjetor Serbisë i bënë thirrje edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës për t'i hetuar pretendimet e vëzhguesve ndërkombëtarë për parregullsi zgjedhore.

SNS-ja në disa raste ka hedhur poshtë akuzat për ndryshim të vullnetit zgjedhor dhe parregullsi.

Qeveria lokale në Sarajevë shpall gjendje alarmi për shkak të ndotjes së ajrit

SARAJEVË, 21 DHJETOR - Pushteti lokal në Sarajevë ka shpallur gjendje alarmi pasi kryeqyteti i Bosnjë-Hercegovinës është një ndër qytetet më të ndotura në botë ditët e fundit, sipas parashikuesit të cilësisë së ajrit "AirVisual".

Kryeqyteti i Kosovës, Prishtina, u rendit në vendin e 16-të si qyteti më i ndotur në botë të enjten në orën 11:00, sipas "AirVisual".

Vetëm Lahores në Pakistan dhe Nju-Delhi në Indi ishin dy qytetet më të ndotura se Sarajeva në gjithë botën mëngjesin e së enjtes. Kryeqyteti i Maqedonisë së Veriut, Shkupi,

është renditur si vendi i nëntë më i ndotur në botë të enjten.

Indeksi i ndotjes së ajrit në kryeqytetin e Bosnjë-Hercegovinës ishte 290 dhe ishte në një nivel që tregon ajër shumë të pashëndetshëm.

Problemi më i madh është përqendrimi i mikrogrimeve të rrezikshme të pluhurit prej PM 2.5, pasi në ajër kishte 245 mikrogramë për metër kub, që është 49 herë më shumë se sasia e toleruar nga standardet e Organizatës Botërore të Shëndetësisë.

Një përqendrim i tillë i këtyre grimave të pluhurit kategorizohet i rrezikshëm për shëndetin.



Kuvendi i Shqipërisë hap rrugën për arrestimin e ish-kryeministrit Berisha

TIRANË, 21 DHJETOR - Kuvendi i Shqipërisë votoi të enjten në favor të kërkesës së Prokurorisë së Posaçme të Shqipërisë (SPAK) për t'ia hequr imunitetin e deputetit, ish-kryeministrit Sali Berisha, duke i hapur rrugën arrestimit të tij nën dyshimin për korrupsion. Prokurorët u kërkuar ligjvënësve javën e kaluar t'ia heqin Berishës imunitetin parlamentar, sepse ai nuk i ishte përmbajtur urdhrat për të raportuar në SPAK çdo dy javë dhe për të mos u larguar nga vendi, derisa po hetohej për korrupsion.

Me 75 vota në favor, Kuvendi e miratoi kërkesën për t'ia hequr Berishës imunitetin parlamentar të enjten.

Në tetor SPAK-u njoftoi se Berisha akuzohet për korrupsion në një rast bashkë me dhëndrin e vet, Jamarbër Malltezi, për privatizimin e paligjshëm të kompleksit sportiv "Partizani".

Opozita u përpoq ta pengojë votimin duke hedhur flakadanë në seancën foltoje dhe në cilës u sigurua nga një numër i madh i rojeve të sigurisë, ndërkohë që pranë ndërtesës së Kuvendit protestuesit e kundërshtuan vendimin.

Berisha, duke folur gjatë protestës pranë Kuvendit, e quajti



vendimin antikushetues. "Kuvendi antidekomratik votoi në kundërshtim me çdo procedurë kushtetuese dhe ligjore për heqjen e imunitetit dhe arrestimin tim. Ky vendim jo që nuk do ta shkatërojë

opozitën, por do ta mobilizojë atë në shkallën më të lartë dhe me moton: 'o sot o kurrë', do t'i japë përgjigjen më të merituar këtij regjimi", tha Berisha.

Kuvendi do t'i njoftojë prokurorët për vendimin e sotëm, pastaj

pritet që ata t'i drejtohen gjykatës për masën ndaj Berishës.

Të hënën Këshilli i Mandateve i Kuvendit të Shqipërisë e çoi në votim heqjen e imunitetit për Berishën me kërkesë të prokurorëve.

Për çfarë akuzohet Berisha?

Berisha, 79 vjeç, u akuzua në tetor se e kishte abuzuar pozitën e tij duke e ndihmuar dhëndrin Jamarbër Malltezi të blejë tokë në Tiranë e cila ishte në pronësi të qytetarëve dhe Ministrisë së Mbrojtjes si dhe t'i ndërtojë 17 ndërtesa banimi në atë tokë.

Berisha dhe Malltezi i kanë hedhur poshtë akuzat, duke pretenduar se rasti ndaj tyre është i nxitur nga partia në pushtet e kryeministrit Edi Rama, Partia Socialiste.

Prej tetorit, deputetët e Partisë Demokratike në opozitë i kanë penguar vazhdimisht seancat e Kuvendit për ta penguar, siç e quajnë ata, sundimin tejet autoritar të socialistëve.

Berisha shërbeu kryeministër i Shqipërisë nga viti 2005 deri më 2013, si dhe si president nga viti 1992 deri në vitin 1997. Shtetet e Bashkuara në maj 2021 dhe Britania e Madhe në korrik 2022 ia ndaluan Berishës dhe familjarëve të tij të afër të udhëtojnë në këto dy vende për shkak të dyshimeve të përfshirjes së tij në korrupsion.

"Çohu": 44 për qind e qytetarëve mendojnë se liderët e partive janë të korruptuar

PRISHTINË, 21 DHJETOR - Organizata "Çohu" ka paraqitur të gjeturat e Raportit për Vlerësimin e Korrupsionit në Kosovë për vitin 2023.

Arton Demhasaj, drejtor i Organizatës "Çohu", ka thënë se raporti i vlerësimit të korrupsionit qëndron mbi hulumtimin e perceptimit të qytetarëve mbi korrupsionin, i cili hulumtim është realizuar gjatë muajve korrik dhe gusht 2023, në të cilin kanë marrë pjesë 1 001 qytetarë nga të gjitha komunat e Kosovës.

Sipas të dhënave, del se 50 për qind e qytetarëve mendojnë se shumica e zyrtarëve janë të përfshirë në korrupsion. "44.1

për qind e tyre i shohin si të korruptuar liderët e partive, 40 për qind ministrat, kurse 39.5 për qind e tyre thonë se deputetët janë pjesë e korrupsionit. 47.4 për qind e qytetarëve mendojnë se disa prej gazetarëve janë të përfshirë në korrupsion. 39.5 për qind mendojnë se edhe mësimdhënësit janë të përfshirë në këtë dukuri. Përderisa thonë se 37.5 për qind e zyrtarëve të sistemit të drejtësisë janë të korruptuar", ka thënë ai.

Sipas tij, të gjeturat e hulumtimit të paraqitur reflektojnë një pasqyrë shumëdimensionale të perceptimit të qytetarëve lidhur



me korrupsionin në sektorin publik, ku është vërejtur një shkallë e gjerë e perceptimit të

qytetarëve për praninë e korrupsionit në nivele politike dhe administrative, në sektorin

e drejtësisë, komunave, sektorin shëndetësor, ATK-së dhe Doganave etj.

Krasniqi: Qeveria aktuale i ka sjellë regres Kosovës, PDK-ja do ta rikthejë modelin efektiv të qeverisjes



GJAKOVË, 21 DHJETOR - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi, ka qëndruar në komunën e Gjakovës, ku ka takuar sipërmarrës, prodhues dhe udhëheqës të qendrave inovative në këtë komunë. Krasniqi, i shoqëruar nga kryetari i Degës së PDK-së në Gjakovë, deputeti Hajdar Beqa dhe nga kryesuesja e Kuvendit Komunal, Arbëneshja Kuqi, në vizitat që u kanë bërë qendrave "BoneVet" e "Jakova Innovation Center", si dhe ndërmarrjes "KoBa", kanë

diskutuar për sfidat me të cilat po përballen ata dhe të gjithë qytetarët e Gjakovës si pasojë e diskriminimit që po ua bën qeveria Kurti, duke mos ndarë asnjë cent për investime të reja kapitale për këtë komunë. "Fatkeqësisht edhe Gjakova është ndër komunat e ndëshkuara nga qeveria Kurti, sepse edhe për Gjakovën nuk është ndarë asnjë cent për investime të reja kapitale për vitin 2024. Është për keqardhje që nuk ka një mbështetje për qytetarët e

komunës së Gjakovës ashtu siç nuk ka pasur as për qytetarët e komunave të tjera. Por, është, po ashtu, për keqardhje që s'ka mbështetje as për ndërmarrësit e komunës së Gjakovës, të cilët vërtet me sfida të shumta, po arrijnë të krijojnë vende pune, t'i mbajnë njerëzit në Gjakovë dhe, po ashtu, të ndikojnë në zhvillimin ekonomik lokal", tha Krasniqi, duke shtuar se qeveria aktuale i ka sjellë regres Kosovës, ndërkaj PDK-ja do ta rikthejë modelin efektiv të qeverisjes.



Osmani dhe Kurti u bëjnë thirrje qytetarëve t'i respektojnë rregullat e liberalizimit të vizave

Qytetarët e Kosovës nga 1 janari i vitit 2024 do të mund të udhëtojnë pa viza në 27 shtete të Zonës Shengen deri në 90 ditë brenda periudhës prej 180 ditësh. Ky regjim, megjithatë, bart disa rregulla që duhet të ndiqen, në të kundërtën pason gjoha ose ndalesa e hyrjes. Presidentja Vjosa Osmani dhe kryeministri Albin Kurti të enjten u kanë bërë thirrje qytetarëve t'i respektojnë të gjitha rregullat që janë pjesë e sistemit të liberalizimit të vizave

**EPOKA
ERE**

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 21 DHJETOR - Presidentja e vendit, Vjosa Osmani, ka thënë të enjten se viti 2023 nuk ka qenë aq i lehtë, pasi jemi përballur me sfida të fushave të ndryshme, nga ajo e sundimit të ligjit dhe deri te dinamika kërkuese në rrafshin e ekonomisë.

Megjithatë, presidentja Osmani ka thënë se 2023-a ishte edhe vit i suksesshëm, pasi nga 1 janari 2024 në fund qytetarët e Kosovës do të lëvizin pa viza në Zonën Shengen. "Ky ishte edhe vit me suksese të veta, duke filluar me faktin se që nga 1 janari më në

fund qytetarët e Kosovës do të lëvizin pa viza në Zonën Shengen. Kjo është një e arritur e institucioneve të Republikës së Kosovës, veçanërisht me të arriturat në fushën e sundimit të ligjit. Njëkohësisht e shfrytëzoj këtë mundësi që t'u bëjë thirrje të gjithë qytetarëve që t'i respektojnë të gjitha rregullat që janë pjesë e sistemit të liberalizimit të vizave", ka theksuar Osmani.

Ndërkaq në Prizren, kryeministri Albin Kurti, zëvendës-kryeministrja e tretë Emilja Rexhepi dhe deputeti Enis Kervan u drejtuan qytetarëve, duke theksuar datën historike të 1 janarit, fillimin e udhëtimeve pa

viza për Kosovën. Edhe kryeministri Kurti u ka bërë thirrje qytetarëve të jenë të kujdesshëm për rregullat e liberalizimit. "Të dashur qytetarë, duhet të jemi të kujdesshëm për rregullat sepse liberalizimin duhet ta përdorni për kënaqësi e mundësi të reja e kurrsesi jo që udhëtimin ta shndërroni në vështirësi e kokëdhimbje sepse pasojat janë të mëdha", ka thënë Kurti.

Udhëtimi pa viza u mundëson qytetarëve të Kosovës që të udhëtojnë pa vizë për qëndrime të shkurtra si turist, por edhe të vizitojnë miqtë apo familjarët, të marrin pjesë në ngjarje kulturore apo sportive, takime biznesi, trajtim mjekësor, për programe arsimore afatshkurtra si seminare, konferenca, punëtori, shkolla verore dhe çdo aktivitet i ngjashëm.

Një qytetar mund të qëndrojë 90 ditë në çdo periudhë 180 ditore brenda Zonës Shengen. "Nëse udhëtoni disa herë, duhet të llogaritni me kujdes ditët e qëndrimit, pasi periudha e përgjithshme e qëndrimit nuk duhet të kalojë totalin prej 90-

ditësh brenda periudhës 180 ditore", ka njoftuar Integrimi Evropian i Kosovës.

Për të udhëtuar pa vizë, kërkohen dokumente të rëndësishme si pasaportë biometrike, dëshmi mbi qëllimin e udhëtimit, rezervimin e vendit të qëndrimit, detajet e udhëtimit, dokumentet për veturën nëse udhëtoni me të, dhe dëshmi për mjete të mjaftueshme financiare. Megjithatë, liberalizimi i vizave nuk ju mundëson të punoni, ta ndiqni shkollimin ose të kryeni studime në zonën Shengen. Shkeljet e rregullave apo abuzimi i kësaj të drejte mund të sjellin pasoja të rënda, duke përfshirë gjoha financiare, shënim në pasaportën tuaj dhe ndalim të hyrjes në Zonën Shengen deri në pesë vjet.

Si funksionon rregulli i tre muajve afat në pasaportë për të hyrë në Zonën Shengen?

"Për të hyrë në Zonën Shengen është e rëndësishme të keni pasaportë me afat të mjaftueshëm. Pasaporta juaj duhet të jetë e vlefshme për së paku tre muaj pas datës së

planifikuar të largimit nga Zona Shengen. Për shembull, nëse planifikoni të hyni në zonën SHENGEN më 1 mars 2024 dhe deklaroni te policia kufitare se do të qëndroni deri më 15 mars 2024, atëherë pasaporta juaj duhet të jetë e vlefshme së paku deri më 15 qershor 2024, pra tre muaj pas datës së planifikuar të kthimit", ka njoftuar Integrimi Evropian i Kosovës.

Institucionet e vendit kanë nisur një fushatë njëmuajore në të gjitha komunat për t'i informuar qytetarët për procedurat e liberalizimit të vizave.

Qytetarët janë informuar mbi rregullat e lëvizjes pa viza përmes materialeve informuese dhe kuizit mbi integrimin evropian. Përveçse janë shpërndarë informata dhe dhurata, qytetarët kanë pasur mundësinë përmes kuisit, të bëhen pjesë e shorteut për udhëtimin e parë pa viza në Vjenë. Fushata për informimin e qytetarëve do të vazhdojë ende përmes televizioneve, rrjeteve sociale dhe përditësimit të informatave në uebfaqen zyrtare të integritit evropian.

Aparaturat për diagnostikim ose nuk punojnë, ose nuk shfrytëzohen

PRISHTINË, 21 DHJETOR - Në disa klinika pacientët duhet të enden për shkak të prishjes së aparaturave, në disa të tjera aparaturat janë moderne dhe funksionale, por nuk ka kush të operojë me to. Kjo situatë vihet re në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës në Prishtinë, çdo ditë e mbingarkuar me pacientë që presin të marrin shërbime.

Avdyl Berisha ishte udhëzuar nga ambulanca e fshatit të tij, Sllatinë - komuna e Fushë-Kosovës - të bënte një rëntgen në QKUK, pasi kishte dyshime për ndrydhje të kockave.

Fillimisht u drejtua në ambulancën specialiste të Ortopedisë, ku iu tha se rëntgeni nuk punon. U end pastaj edhe nëpër disa ambulanca të tjera, derisa përfundoi në Klinikën Emergjente. "E kam bërë në Emergjencë, por nuk po duket mirë. Tri herë kam ardhur këtu... jo hyr në bodrum, jo dil atje...", tha Berisha shkurtimisht për "Radion Evropa e Lirë".

QKUK-ja ka 22 ambulanca specialiste me vetëm një rëntgen.

Kjo pajisje - që u shërben mjekëve për të parë dhe vlerësuar kockat e thyera, por edhe për të diagnostikuar probleme të tjera në trupin e

njeriut - nuk punon aty për më shumë se dy muaj.

Se kur do të kthehet në funksion nuk është e qartë. "Pas verifikimit të prishjeve, Drejtorja e Shërbimit Spitalor Klinik dhe Universitar të Kosovës (SHSKUK) i ka marrë të gjitha masat dhe ka hapur procedurat e tenderimit që aparaturat të rregullohen", thotë për "Radion Evropa e Lirë" drejtoresha e Klinikës së Radiologjisë, Shkëndije Nuza, pa dhënë ndonjë informacion më konkret. Klinika që udhëheq ajo është përgjegjëse për aparaturat që funksionojnë me rreze brenda QKUK-së. E rëntgeni i ambulancave specialiste nuk është i vetmi që nuk punon. Në Klinikën e Neurologjisë, për më shumë se tre muaj, nuk është duke punuar as CT-ja, apo aparatura për skanim të trupit. CT-ja shërben për të identifikuar sëmundje të ndryshme brenda trupit të njeriut, përfshirë edhe tumoret.

Drejtori i Neurologjisë, Edmond Komoni, thotë se mosfunksionimi i saj po u shkakton vështirësi si pacientëve ashtu edhe punonjësve. "Meqenëse rastet janë të rënda te Klinika e Neurologjisë, pacientët lëvizin me vështirësi... Ne mundohemi t'i kompensojmë...

shfrytëzojmë tomografitë e kompjuterizuara, të cilat gjenden tek Emergjencia ose tek objekti i Onkologjisë, por për shkak se pacientët duhet të barten... kjo na merr shumë kohë dhe na e vështirëson punën", thotë Komoni për "Radion Evropa e Lirë".

As për këtë aparaturë, askush prej mjekëve apo stafit tjetër nuk ofron informacion të saktë se kur do të kthehet në funksion, derisa disa metra më larg, në Klinikën e Pediatrisë, qëndron aparatura MRI, e cila është funksionale vetëm deri në orën 13:00 - pas kësaj kohe nuk ka mjekë për të operuar me të.

Aparatura për imazhe me rezonancë magnetike, e njohur si MRI, është më e kushtueshme se CT-ja dhe përdoret për zbulimin e sëmundjeve, diagnostikimin dhe monitorimin e trajtimit.

Me të operojnë radiologët, 28 sish në QKUK, por tash për tash nuk ka orar për ndërrimin e dytë. Udhëheqës të QKUK-së konfirmojnë për REL-in se kanë kërkuar nga Klinika e Radiologjisë që ta shqyrtojë zgjatjen e orarit të punës me MRI, por se vendimi është ende në shqyrtim e sipër.

Për arsye të tjera, në Klinikën e Urologjisë nuk shfrytëzohet gati fare laparaskopi, i cili ndihmon

në diagnostikimin e një game të gjerë sëmundjesh, sidomos në abdomen, por edhe për të kryer procedura kirurgjikale. "Janë kryer disa raste - cista të veshkës, ndërsa operime të tjera nuk janë bërë me laparoskop... Për të vazhduar me operacione të tjera laparoskopike, duhen trajnime në vazhdimësi. Shpresoj që, vitin që vjen, në bashkëpunim me ShSKUK-në dhe Ministrinë e Shëndetësisë, t'i dërgojmë kolegët për trajnime laparoskopie [jashtë shtetit]", thotë drejtori i Urologjisë, Petrit Nuraj, për "Radion Evropa e Lirë".

Në Kirurgjinë Plastike të QKUK-së, ndërkaq, minimalisht përdoret mikroskopi për implantimin e gishtërinjve.

Drejtoresha e kësaj klinike, Violeta Zatriqi, thotë se nuk ka staf të mjaftueshëm që është i specializuar për përdorimin e kësaj pajisjeje. "Është edhe një problem tjetër, se mikroskopi ndodhet në Klinikën e Kirurgjisë Plastike, ndërsa rastet urgjente kryhen në Emergjencë dhe mikroskopi nuk është aparat që mund të lëvizë... Kjo është një prej arsyeve pse nuk shfrytëzohet në rastet emergjente", thotë ajo.

Të gjitha këto aparatura që nuk shfrytëzohen me kapacitete të plota janë të vjetra vetëm 1-2 vjet

dhe me kosto prej qindra mijëra eurosh.

Në ShSKUK - institucionin që ka në përgjegjësi QKUK-në dhe të gjitha spitalet rajonale të Kosovës - thonë për "Radion Evropa e Lirë" se janë duke i shqyrtuar mundësitë për trajnime shitesë të stafit, por se, fillimisht, janë duke marrë informacione nga të gjitha klinikat, për të kuptuar se cilat aparatura nuk shfrytëzohen dhe pse.

REL-i, edhe në mars të këtij viti, ka raportuar për së paku dy aparatura në Klinikën e Pediatrisë të QKUK-së, të cilat me vite nuk janë përdorur - qoftë për mungesë të materialit, apo të stafit.

Sipas kësaj ode, të larguarit - që kryesisht emigrojnë drejt vendeve të Bashkimit Evropian - ankohen për kushte jo të mira pune, paga të ulëta dhe keqmenaxhim.

Paga bruto e një mjeku specialist në Kosovë është rreth 1 200 euro, ndërsa në Gjermani, për shembull, arrin në mbi 4 000 euro.

Mungesa e mjekëve në klinika të caktuara shkakton edhe lista të gjata pacientësh që vihen në pritje. Por, pritjet e gjata në QKUK janë shpesh edhe pasojë e dyndjes së pacientëve nga spitalet rajonale.



Rektori i UP-së nderon me mirënjohje profesorin Rainer Waldhardt

PRISHTINË, 21 DHJETOR - Rektori i Universitetit të Prishtinës, Qerim Qerimi, ka nderuar prof. dr. Rainer Waldhardt për kontributin e jashtëzakonshëm në zgjerimin e bashkëpunimit ndërmjet Universitetit të Giessenit dhe Universitetit të Prishtinës.

Certifikata e mirënjohjes i ndërlihd përpjekjet e tij të pakrahasueshme për fuqizimin e rrjedhës së dijes

dhe mbështetjen e profesorëve, administratës dhe studentëve në rrugën e tyre drejt suksesit profesional. Përveç bashkëpunimit në projekte kërkimore dhe ligjërimit në UP, profesori Waldhardt ka mentoruar në nivel studimi të doktoratës dhe master një numër të konsiderueshëm të kandidatëve të diplomuar në UP, disa prej të cilëve tashmë janë anëtarë të stafit akademik.

Rektori Qerimi tha se është nder për universitetin që të ndajë mirënjohje për punën dhe kontributin e profesor Waldhardt, dhe theksoi gatishmërinë e UP-së për ta zgjeruar horizontin ekzistues të bashkëpunimit.

Në anën tjetër, profesori Waldhardt u shpreh thellësisht mirënjohjes dhe falënderues për vlerësimin dhe përvojën e tij në Universitetin e Prishtinës.



Për herë të parë në Kosovë fillon shërbimi i sedacionit inhalatorë në Klinikën e Stomatologjisë

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 21 DHJETOR - Ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, ka vizituar Qendrën Klinike Universitare Stomatologjike të Kosovës, ku pa nga afër fillimin e shërbimit për përdorimin e sedacionit inhalatorë me N2O/O2 në praktikën stomatologjike të shërbimit stomatologjik pediatrik, shërbim ky që funksionalizohet për herë të parë në Republikën e Kosovës dhe njëherësh i vetmi në rajon në sistemin publik të shërbimeve dentare.

Ministri Vitia ka theksuar se në fokus të politikave shëndetësore

të Ministrisë së Shëndetësisë janë shërbimet stomatologjike për fëmijët, me theks të veçantë programet edukative, preventive dhe ato terapeutike. "Ndihej lumtur që sot jam në mesin tuaj me rastin e fillimit të këtij shërbimi kaq të rëndësishëm dhe të domosdoshëm, sidomos për fëmijët me nevoja të veçanta dhe fëmijët të cilët nga ankthi, frika dhe nga procedurat e tjera stomatologjike u pamundësohet qasja në shërbime stomatologjike dhe si pasojë e dhëmbëve të prishur u cenohet edhe rritja dhe zhvillimi i tyre", ka pohuar Vitia.

Po ashtu, Vitia ka thënë se në bazë të raporteve të marra nga



shërbimet primare në nivel vendi, gjendja e shëndetit oral të fëmijët në vendit tonë është jo e

kënaqshme dhe nga kjo, në bashkëpunim me Odën e Stomatologeve të Kosovës do të

hartohet Strategjia Nacionale për Shërbimet Stomatologjike, ku kjo strategji do të ketë në fokus të veçantë, edukimin mbi shëndetin oral, shërbimet preventive dhe shërbimet konzervative ndaj fëmijëve në moshën e re.

Sedacioni inhalator për pacientin nuk shkakton analjezion të plotë, por ka për qëllim: Reduktimin e frikës dhe ankthit gjatë trajtimit; rritjen e pragut të ngacmueshmërisë së dhimbjes; minimizimin e lëvizjeve të padëshirueshme dhe reagimet ndaj trajtimit stomatologjik, si dhe përmirësimin e komunikimit dhe kooperimit të pacientit.

Nënshkruhet marrëveshja 6 milionë euro për efizienzë të energjisë në ndërtesa publike



PRISHTINË, 21 DHJETOR - Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati, drejtori i Bankës për Rindërtim dhe Zhvillim, Sergey Maslichenko dhe kryetari i Prishtinës, Përparim Rama, kanë nënshkruar të enjten marrëveshje granti me vlerë 1 milion euro si dhe 5 milionë euro kredi të butë për efizienzë të energjisë në ndërtesat publike në Prishtinë.

Përmes këtij projekti do të mundësohet që 47 ndërtesa publike në komunën e Prishtinës të kenë ngrohje eficiente përmes sistemeve të reja të ngrohjes,

izolimit termik si dhe zëvendësimit të dymave dhe dritareve.

Në ceremoninë e nënshkrimit, ministri Murati ka theksuar se ky projekt mundëson që të gjithë qytetarët përfshirë fëmijët e të moshuarit t'i marrin shërbimet e tyre në ambiente më të përshtatshme. "Ne përgëzojmë palët në arritjen e kësaj marrëveshje me një rëndësi të madhe dhe urojmë që projekti të zbatohet sa më parë", ka thënë drejtori Maslichenko.

Ndërsa kryetari Rama ka falënderuar ministrin Murati dhe

drejtorin Maslichenko, duke theksuar se ky kontribut ka qenë shumë i nevojshëm për kryeqytetin e Prishtinës pasi ndërtohet kanë nevojë për rindërtim dhe restaurim.

Kjo marrëveshje me vlerë granti prej 1 milion eurosh nga Programi Rajonal për Efizienzë të Energjisë për Ballkanin Perëndimor të financuar nga Bashkimi Evropian, së bashku me marrëveshjen paraprake me BERZh-in, e cila ka një vlerë prej 5 milionë eurosh, e bën vlerën totale të investimit për këtë projekt 6 milionë euro.

Një hap tjetër drejt mbrojtjes dhe promovimit të fshatit Zym

PRISHTINË, 21 DHJETOR - Grupi punues diskutoi metodologjinë për studimin e fizibilitetit për fshatin Zym i Hasit, duke përfshirë aktivitetet e planifikuar dhe u pajtua për punën e përbashkët në të ardhmen.

Në kuadër të këtij takimi kishin edhe rastin ta shohin përvojën me planin e konservimit dhe menaxhimit të Janjevës, mbi metodologjinë e përdorur, procesin, sfidat dhe

rezultatet.

Duke përfshirë të gjithë palët relevante të interesit, ky studim do ta përcaktojë mbrojtjen, konservimin, zhvillimin dhe promovimin e fshatit Zym i Hasit, një zonë me vlera të trashëgimisë për brezat e tanishëm dhe të ardhshëm. Studimi do t'i analizojë fuqitë e ndryshimit në aspektet kulturore, mjedisore dhe socio-ekonomike dhe do të mundësojë një mbrojtje të

koordinuar, përmirësim dhe zhvillim. Do të identifikojë qëllime afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata për mbrojtjen dhe zhvillimin e zonës dhe do të zhvillojë strategji dhe veprime inovative për arritjen e tyre.

Ky projekt i financuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, dhe i mbështetur nga UN-Habitat Kosovo, përmes Programit për Zhvillim Gjithëpërfshirës të financuar nga Qeveria e



Suedisë, synon integrimin e trashëgimisë kulturore në kuadër të planifikimit

hapësinor për zhvillim të qëndrueshëm, të gjelbër dhe gjithëpërfshirës.

Reagim i KMDLNj-së

Kush po thërret për luftë në Kosovë?!

Persona të papërgjegjshëm nga studiot televizive po deklarojnë se lufta në Kosovë vetëm sa nuk ka filluar. Analistë të afërt dhe të financuar nga qeveria madje e tregojnë edhe kohën kur do të ketë sulme në Veri të Kosovës në ndërkohë që edhe KM i Kosovës, Albin Kurti dhe presidentja Vjosa Osmani thuaja në çdo takim me të huajt por edhe në paraqitje publike thonë se sulmi si ai i Banjskës mund të përsëritet në ndërkohë që shprehen të gatshëm që me të gjitha mjetet e mundshme të mbrojnë Kosovën dhe, në fakt asnjëri prej këtyre që po alarmojnë për luftë të mundshme në Kosovë nuk ka kontribuar me asgjë dhe kanë qëndruar për shkaqe objektive a subjektive larg luftës ani pse kanë mundur të jenë pjesë e luftës kur kërkohej sakrificë për liri dhe çlirim. Kosova po përballet me një situatë të rënduar ekonomike dhe një shumicë e qytetarëve të saj po përballet me probleme të mbijetesës dhe diskutimet për luftë të mundshme përmes përhapjes së frikës është përpjekje perfide për të zhvendosur vëmendjen nga situata shpërthyes sociale sikur edhe nga një largim masiv i qytetarëve të Kosovës pas datës 1 janar 2024, koha kur hiqen vizat për shtetasit e Kosovës. Kërcënimet me luftë bëhen edhe për të mbuluar dështimet e institucioneve thuaja në të gjitha fushat hiç këtu sportin që ka pasur sukses të konsiderueshëm gjatë vitit 2023. Pas sulmit të Banjskës për të cilin KMDLNj dyshon se është bërë i orkestruar për të përshpejtuar zbatimin e marrëveshjes për normalizim me Serbinë e që për Kosovën, për aq sa është e qasshme për opinion është shumë e dëmshme, retorike luftënxitëse është bërë dukuri e përditshme, në njërin anë, kurse, në anën tjetër thuhet se kemi përmirësim të madh të situatës së sigurisë në Veri të Kosovës dhe pranim të



institucioneve të Kosovës nga ana e serbëve lokalë. Për këtë, si tregues të këtij përmirësimi merren rënia e numrit të incidenteve në këtë pjesë të Kosovës dhe sidomos pajisja e qytetarëve serbë me tabela RKS e që më parë i refuzonin. Që paradoksi të jetë më i madh dhe që vë nën dyshim pohimet e institucionet e Kosovës tregon fakti se prania e trupave paqeruajtëse - KFOR-it në veri të Kosovës thuaja është dyfishuar dhe ata, në një mënyrë apo tjetër ushtrojnë kompetenca edhe të policisë. Realisht, në aspektin e funksionimit të sigurisë në veri të Kosovës, hallka kryesore në këtë zinxhir është pikërisht KFOR-i

dhe pa pëlqimin e tyre nuk mund të ndërmerret asnjë veprim në fushën e sigurisë. Dështimet katastrofale në politikën e jashtme, turpërimi në arsim përmes testit PISSA, improvizimet me ndihma akute (100) euro për kategoritë sociale, mungesa e investimeve kapitale, rritja e ndjeshme e korrupsionit në të gjitha nivelet, ndërhyrja flagrante e qeverisë në punën e institucioneve të pavarura, nepotizmi galopant, mungesa e transparencës dhe llogaridhënies mundohen të mbulohen me kërcënimet të vazhdueshme të luftës nga Serbia, ndërhyrjen e Rusisë në Kosovë, ndikimin e luftës në Ukrainë si shkas për

përkeqësim të situatës së sigurisë në Kosovë e gjëra të tjera të ngjashme. KMDLNj thërret të gjithë akterët të jenë të përmabajtur dhe të përgjegjshëm në deklaratat e tyre, të mos flasin për gjëra që nuk është fare përgjegjësi e tyre dhe as nuk i pyet askush dhe që nuk kanë asnjë ndikim ndërsa thërret institucionet e Kosovës që të angazhohen për zgjidhje të problemeve jetike për qytetarët e Kosovës dhe të mos merren me tema të mëdha për të cilat nuk pyeten nga askush dhe nuk kanë asnjë ndikim, as për zgjidhjen e tyre e as për përshkallëzim të situatës. Qytetarët duan jetë më të mirë, institucionet e sigurisë

duan kushte më të mira të punës dhe të ardhura më të mira, sigurime shëndetësore dhe sigurime jetësore, arsim më cilësorë në të gjitha nivelet si edhe shërbime shëndetësore më të mira. Duan një mjedis të pastër dhe jo të mbytur nga mbeturinat, hapësira të blerta dhe barazi para ligjit. Duan mundësi të barabarta gjatë punësimit dhe gradimit. Thjeshtë, duan të kenë një ardhmëri në Kosovë dhe të cilën aktualisht nuk e kanë ose e kanë fare të pasigurt. Këta që po thërassin për luftë, as që e kanë bërë luftën e as që do ta bëjnë, nëse hipotetikisht edhe vjen deri te lufta për çka KMDLNj nuk beson se do të ndodhë.

Institucionet zbatojnë vetëm 20 për qind të rekomandimeve të Avokatit të Popullit



PRISHTINË, 21 DHJETOR - Avokati i Popullit, Naim Qelaj, ka thënë se deri më tani 20 për qind e rekomandimeve nga ky institucion janë zbatuar, ndërsa janë në pritje të zbatimit edhe 80 për qind të rekomandimeve. Ai në takimin e Këshillit për Demokraci dhe të Drejta të Njeriut, tha se zbatimi i rekomandimeve të Avokatit të Popullit duhet të jetë prioritet. "Këtë vit të dhënat nuk janë edhe shumë inkurajuese, megjithatë jemi ende herët për të ardhur në një përfundim, deri më tani 20 për qind të rekomandimeve të

Avokatit të Popullit janë zbatuar, 80 për qind e rekomandimeve janë në pritje të zbatimit. Pra, kemi një numër të madh të rekomandimeve që presin zbatim nga autoritetet dhe institucionet e vendit. Nëse rekomandimet e Avokatit të Popullit prekin të gjitha sferat e drejtave të njeriut dhe pasqyrojnë vetë gjendjen e të drejtave të njeriut në Kosovë, besoj se është përgjegjësi e të gjitha autoriteteve që zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit ta kenë prioritet", ka thënë Qelaj.

Kosova gjobit MTS-në me 1.5 milion euro për shkelje të Ligjit të Konkurrencës

PRISHTINË, 21 DHJETOR - Autoriteti i Konkurrencës i Kosovës njoftoi të mërkurën se e ka gjobitur ndërmarrjen MTS d.o.o me mbi 1.5 milion euro për shkeljen e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

MTS d.o.o. e ka për kompani amë operatorin shtetëror të telekomunikacionit, Telekom i Serbisë, dhe u themelua në tetor të vitit 2015 në përputhje me Marrëveshjen e Brukselit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë në kuadër të dialogut për normalizimin e marrëdhënieve.

Selia e kësaj ndërmarrjeje shoqërore është në Mitrovicën e Veriut, komunë e banuar me shumicë serbe në veri të Kosovës. Megjithatë, ajo ka degë edhe në komunat tjera të banuara me shumicë serbe në Kosovë: Leposaviq, Zubin Potok, Graçanicë, Shtërpçë dhe Ranillug. Ky vendim vjen disa muaj pasi Qeveria e Kosovës ia hoqi licencën biznesore kësaj kompanie për shkak të dokumentacionit të kontestuar gjatë regjistrimit të biznesit.

Autoriteti tha, sipas vendimit që e mori më 18 dhjetor, se MTS d.o.o. e shkeli ligjin "duke mos parashtruar

kërkesën për njoftimin e detyruar për përqendrim për blerjen e 100 për qind të aksioneve të ndërmarrjeve: VGN NET d.o.o., LIKA d.o.o., PP. PRKDS-IMPULS në emër të I. R. - B.I. dhe Herc International".

Verën e kaluar emri i kompanisë MTS d.o.o. u gjet në listën e kompanive të cilave mund t'u ndalohej veprimtaria e të bërit biznes në Kosovë, sepse në formularin e regjistrimit shkruan se ndodhet në territorin e Serbisë, përkatësisht shkruan "Mitrovica e Kosovës (Kosovska Mitrovica), Republika e Serbisë".

Lista e kompanive me vendndodhje gjeografike të ngjashme të kontestuar është përpiluar nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë e Kosovës, pasi mediumit "Klan Kosova" iu pezullua certifikata e biznesit për të njëjtin arsye.

Ligji për Mbrojtjen e Konkurrencës

Ligji i ri për Mbrojtjen e Konkurrencës ka hyrë në fuqi në



qershor të vitit 2022 dhe parashikon që pjesëmarrësit në një përqendrim, d.m.th në uljen e numrit të pjesëmarrësve në treg, në disa raste duhet të kërkojnë paraprakisht leje nga Autoriteti i Konkurrencës.

Në ligj, "përqendrimi" përshkruhet si "ndryshim i qëndrueshëm i kontrollit të

ndërmarrjeve kur bashkohen ndërmarrje të pavarura ose pjesë të tyre ose kur një a më shumë ndërmarrje fitojnë kontroll të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të tërësisë ose pjesëve të ndërmarrjeve të tjera, sidomos duke fituar aksione...".

Deri në mesin e vitit të kaluar ishte në fuqi ligji, sipas të cilit, nuk ishte

e nevojshme leja për pjesëmarrje në përqendrim, pra blerje të kompanive të tjera të ngjashme. Por, në bazë të ligjit të mëparshëm, Autoriteti i Mbrojtjes së Konkurrencës kishte të drejtë të niste një procedurë për rishikimin e marrëveshjeve ndërmjet shoqërive, nëse konstatohesh se një kompani dominonte.

Demokracia Plus: Ndërmarrjet publike s'po i zbatojnë planet vjetore të prokurimit publik



PRISHTINË, 21 DHJETOR - Demokraci Plus ka publikuar analizën në lidhje me problemet kryesore në zbatimin e planeve vjetore të prokurimit publik në ndërmarrjet

publike. Egzona Kuzhani, hulumtuese e prokurimit publik, ka theksuar se plani që po paraqitet është udhërrëfyes për institucionet që

duhet të bëjnë planifikime jo më pas se 30 ditë para çdo viti fiskal. Ardit Dragushi nga kjo organizatë ka pohuar se planet vjetore nuk po arrijnë të zbatohen në praktikë

dhe pjesa më e madhe e kontratave po vonohen. Ai ka paraqitur në hollësi mosrealizimin e kontratave nga disa ndërmarrje publike.

"Hortikultura, Trafiku urban, Ibër Lepenci, problem kryesor kanë planet vjetore, sepse nuk arrijnë ta zbatojnë në praktikë pjesën më të madhe të kontratave të cilat nuk iniciohen sipas planifikimit fillestar. Hortikultura në planin përfundimtar të prokurimit për vitin 2023 planifikoi iniciimin e 74 kontratave në 6-mujorin e parë të vitit në vlerë të përgjithshme 896 749.00 euro. Nëse krahasojmë numrin e kontratave të planifikuara me ato të realizuara nga plani, atëherë del se vetëm 18.9 % e planit është realizuar ashtu siç ishte planifikuar. Trafiku urban planifikoi iniciimin e 34 kontratave me vlerë të përgjithshme 3 268 981.05, nga numri i kontratave të planifikuara 26.4 % u iniciuan, ndërkohë vlera e tyre ishte 7 625 254.47 euro. Ndërsa ndërmarrje Ibër Lepenci në planin përfundimtar të prokurimit planifikoi 32 kontrata në 6-mujorin e parë të vitit në vlerë të përgjithshme 1 895 507.00 euro", ka thënë Dragushi.

Numri i sekuestrimeve, konfiskimeve dhe luftimi i evazionit fiskal kanë shënuar rritje

Prishtinë, 21 dhjetor - Ministria e Financave ka njoftuar se ka rritje për mbi 130 për qind të të hyrave të inkasuara falë masave për luftimin e ekonomisë joformale nga Dogana e Kosovës. "Të dhënat nga Dogana e Kosovës tregojnë se numri i sekuestrimeve,

konfiskimeve dhe luftimi i evazionit fiskal kanë shënuar rritje të theksuar. Në periudhën janar-nëntor 2023 vlera e konfiskimeve e sekuestrimeve ka shënuar rritje prej 137.4-përqindësh krahasuar me periudhën janar - dhjetor 2019. Ndërsa falë masave për luftimin e

evazionit fiskal (p.sh rivlerësimi i mallrave gjatë zhdoganimit) të hyrat e inkasuara janë rritur për 160.9 për qind në periudhën janar - nëntor 2023, krahasuar me periudhën janar - dhjetor 2019", ka njoftuar kjo ministri.



Nënat e fundit të Sheshit Tienanmen



PEKIN. Zhang Xianling përgjigjet me një zë të butë. Disa fjalë të ndërprera aty-këtu nga një lidhje telefonike jo e qëndrueshme. Ka të ngjarë që ka veshë të tjerë që dëgjojnë në telefonin e shtëpisë. Zhang është një nga themelueset e Nënave të Tiananmenit, gra të guximshme që për tridhjetë e katër vjet kanë kërkuar nga Partia Komuniste Kineze të vendoset drejtësi për atë që ndodhi natën midis 3 dhe 4 qershorit 1989, kur tanket hynë në zemrën e Pekinit, duke shtypur kërkesat për reforma dhe hapje të dhjetëra mijëra të rinjve që pushtuan paqësisht sheshin e pushtetit të kuq, për 50 ditë. Gratë që humbën fëmijë, por edhe vëllezër e burra në atë masakër.

Një “aksident”, siç e cilëson PKK, e që mbetet një temë tabu. Ende nuk dihet numri i të vdekurve. Megjithatë, kujtimi i asaj nate në Pekin mbi tre dekada më parë nuk është zbehur. Edhe pse gjithnjë e më pak njerëz e mbajnë mend.

Në fakt, nënat sapo kanë humbur një tjetër nga shoqëruet e tyre luftarake, Zhou Shuzhuang, 87 vjeçe, e cila në atë masakër humbi

djalin e saj 24 vjeç, Duan Canglong, i diplomuar në kimi nga Universiteti prestigjioz Tsinghua në Pekin, dhe i vrarë pak kohë më pas, në orën një të natës më 4 qershor 1989, nga Ushtria Popullore Çlirimtare. E qëlluan pranë Pallatit të Kombeve, në Chang’an Jie, “rruga e paqes së përrjetshme”, rruga e gjatë që të çon në Tiananmen. Zhou iku nga kjo botë pa e gjetur atë paqe.

NËN KONTROLL

Zhang nuk ishte në gjendje të shkonte në funeralin e Zhou, por ajo dërgoi një kurorë me lule. “Po pushoj prej një pneumonie të lehtë. Fatmirësisht asgjë serioze”, thotë nga shtëpia e saj në Pekin. “Ne nuk takohemi më shumë shpesh, për fat të keq. Jemi të gjithë shumë të moshuara tani, mbi 80 vjeç. Covid ka pasur një ndikim shumë të fortë tek ne”. Një mënyrë për të thënë se grupi i tyre, vit pas viti, bëhet gjithnjë e më i vogël.

Por Zhang është e qetë, e lumtur të flasë – edhe pse vetëm disa minuta – me një gazetar të huaj. Ajo na paralajmëron menjëherë:

«Do të isha e lumtur të jepja një intervistë, por nëse provoni të vini këtu, me siguri do të gjeni roje jashtë shtëpisë që do t’ju bllokojnë. Më ndodhi muajin e kaluar me një mik gazetar japonez që donte të më vizitonte përpara se të largohej nga Kina. Më telefonoi dhe më pyeti nëse isha në shtëpi. Unë i thashë po. Kjo nderi alarmin dhe për njëzet ditë kishte kontrollë kudo pranë shtëpisë sime. Nuk mund të takoheshim. Nuk e kuptoj pse autoritetet janë kaq nervozë ndaj nesh”.

E NDALUAR TË KUJTOSH

Partia, megjithatë, e kupton mirë. Çdo vit nënat u shkruajnë autoriteteve duke kërkuar shpjegime dhe drejtësi.

Shumë prej tyre, duke përfshirë edhe bashkëthemeluesen tjetër, Ding Zilin, vitet e fundit kanë qenë shpesh të mbyllura në shtëpitë e tyre në ditët “e ndjeshme” para dhe pas përvjetorit të masakrës. Në shkollat kineze masakra e Tiananmenit nuk tregohet në asnjë libër shkollor, nuk

eksplorohet në thellësi nga asnjë kanal televiziv dhe nuk përkujtohet nga asnjë monument. Çdo material në internet censurohet menjëherë. Përkujtimet publike janë absolutisht të ndaluara.

Menjëherë pas masakrës, Ding Zilin dhe bashkëshorti i saj kontaktuan familjet e tjera. Zhang Xianling ishte e para që bëri një hap përpara: edhe ajo kishte humbur një djalë, vetëm 19 vjeç. Të privuara nga e drejta për të qarë publikisht, Zhang dhe Ding u bënë bashkë, duke i dhënë dalëngadalë jetë këtij grupi që sot numëron pak më shumë se njëqind vetë, jo vetëm gra – “por mos na quani organizatë”, na korrigjon ajo në telefon – të cilët mbështesin njëri-tjetrin, mbledhin informacion dhe regjistrojnë me përpikmëri detaje në lidhje me identitetin e viktimave dhe rrethanat e vdekjes së tyre.


Me kalimin e viteve ata kanë përpiluar një listë që tani ka 202 vdekje: shumica ishin studentë midis 17 dhe 25 vjeç. Lista nuk është aspak e plotë, por është rrëfimi më gjithëpërfshirës i

viktimave të Tiananmen-it që ekziston.

ASNJË MASAKËR

“Asnjë nga qeveritë që kanë pasuar njëra-tjetrën në krye të vendit nuk ka pyetur kurrë për ne dhe askush nuk ka thënë kurrë një fjalë falje, sikur masakra të mos kishte ndodhur kurrë”, shkruajnë Nënat në disa nga letrat e hapura dërguar gjatë këtyre viteve tek autoritetet komuniste.

“Të kërkojmë nga qeveria që të përgjigjet për masakrën sipas ligjit, është e drejta jonë legjitime. Prej 34 vitesh ne ndjekim në mënyrë paqësore dhe të arsyeshme tre kërkesat për të vërtetën, dëmshpërblimin dhe përgjegjësinë, duke kërkuar dialog. Historia e 4 qershorit është kthyer në një temë të ndaluar. Ne, familjet e viktimave, jemi bërë një grup i marginalizuar njerëzish që vuajnë. Të vetmit njerëz që vijnë për të na vizituar janë policia, apo personeli i Ministrisë së Sigurimit të Shtetit”. E megjithatë, pavarësisht gjithçkaje, nënat e Tiananmenit ende nuk janë dorëzuar. / Gianluca Modolo (Il Venerdì) – bota.al



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Ramadani, nga shitës i frutave në zbulimin e Serisë A



LECCE, 21 DHJETOR - "Kam bërë një xhiro nëpër Evropë për të mbërritur te Lecce". Ylber Ramadani duket i dashuruar me klubin e tij të ri, ku zbarkoi disa muaj më parë. Askush nuk flet më për Morten Hjulmand, "playmakerin" e mirë danez të shitur në verë te Sporting në Portugali. Tani shumë flasin, dhe vetëm në terma pozitivë, për numrin 20 të verdhekuqve, i cili të shtunën, me golin nga jashtë zonës, në minutën e 89, i dha skuadrës së Roberto D'Aversa fitoren që i mungonte prej 22 shtatorit. Ai e dërgoi topin në rrjetë, pastaj e mori dhe e futi poshtë fanellës e brohoriti i gëzuar: "Partnerja ime kosovare dhe unë tashmë kemi një vajzë një vjeçe e tetë muajsh, që ka lindur në Budapest". Pavarësisht se është 27 vjeç, ai tashmë e ka parë Evropën: Kosovën, Shqipërinë, Danimarkën, Hungarinë dhe, "më në fund", Italinë: "Nuk ka mbaruar. Kam lindur në Gjermani, pastaj jam kthyer në Kosovë. Në shtëpi kishim probleme financiare, por doja vetëm të luaja futboll. Babai donte që unë të punoja me të duke shitur shalqinj dhe fruta në treg, por pasi më pa të luaja ndeshjen e parë më tha: shko, luaj futboll. Hapi më i rëndësishëm ishte kalimi tek Aberdeeni i Skocisë, niveli atje ishte dukshëm më i lartë se në Danimarkë dhe Hungari. Falë paraqitjes atje fitova Kombëtaren dhe Italinë".

A janë gjërat më mirë në familjen tuaj tani?

Ramadani: Absolutisht. Babai ka një dyqan, vëllai im ka dy.

Jeni nga Kosova, por zgjodhët të luanit me kombëtaren e Shqipërisë...

Ramadani: Unë kam dy pasaporta.

Ndihem sikur iu përkas të dy vendeve, por zgjedha Shqipërinë dhe në Evropian do ta sfidojmë Italinë.

Si jeni si Kombëtare?

Ramadani: Jemi një ekip i mirë, me 9 futbollistë që luajnë në Serinë A dhe kjo sigurisht që ndihmon. Pëlqejmë të luajmë me skemën 4-2-3-1. Ne flasim edhe italisht me Sylvinho, siç folëm me Rejan, që i parapriu. Do të donim të ishim surpriza e Evropianit. Unë, gjithashtu, luaj me rol pak më sulmues atje. Si Asllani dhe Bajrami.

Në fundjavë do ta sfidosh shokun tënd, Asllanin. Çfarë prisni ndaj Interit të pandalshëm?

Ramadani: Interi është skuadra më e fortë e Serisë A, e cila, për më tepër, po kalon një kohë të mirë. Me Kristjanin në kombëtare kemi një ritual: në mëngjes e pimë gjithmonë kafën bashkë. Të shtunën do t'i shkëmbejmë fanellat.

A mund ta përballojë Lecce një kundërshtar si zikaltrit?

Ramadani: Pika jonë e fortë është se jemi një ekip. Ne jemi të bashkuar. Nëse grupi është funksional, ju merrni rezultate. Në dhomën tonë të zhveshjes vetëm qeshet, bëjmë shumë shaka.

Si po shkon me D'Aversa? Ai ju besoi menjëherë?

Ramadani: Shumë mirë, ai më ndihmoi shumë dhe më ndihmon ende duke punuar përtej stërvitjes normale, mënjane. Më thotë se duhet të gjuaj dhe kur kam hapësirë e bëj. Me goditje nga distanca kam shënuar tetë gola në karrierën time, vetëm një me

Shqipërinë.

Dhe kështu këtu në Lecce nuk flasim më për Hjulmand...

Ramadani: E dija që nga dita e parë se duhej të jepja shumë e më shumë, gjithmonë 100 për qind. Ai ka qenë i rëndësishëm këtu dhe ka bërë shumë mirë. E di që duhet të punoj, të punoj, të punoj.

Si arritët te Lecce?

Ramadani: Më kërkonte edhe Verona, por e pashë këtë projekt, seriozitetin e klubit dhe nuk kisha asnjë dyshim të zgjidhja.

Me kë kaloni më tepër kohë në ekipin tuaj?

Ramadani: Me Berishën që vjen nga 'Primavera', por të jeni të sigurt se do t'i bëjë vend vetes në ekipin e parë. Ai është një lojtar që mund të bëjë gjithçka. Si unë.

Ku doni të shkoni?

Ramadani: E lehtë për t'u thënë, në Ligën e Kampionëve.

Kush ju bëri përshtypje në Serinë A?

Ramadani: Kvara, Osimhen, por edhe Anguissa. Dhe Baschiroto ynë, një udhëheqës i vërtetë.

Te Lecce duket se jeni përshtatur mirë...

Ramadani: Që nga dita e parë më bënë të ndihem si një prej tyre, duke më mirëpritur në mënyrën më të mirë. Banoj në qendër të qytetit. Problemi i vetëm është parkimi. Këtu halet shumë mirë. Makaronat me domate e qersh, si dhe picat janë më të pëlqyerat prej meje.

SHKURT

Bashkimi e transferon Zeqirin nga Prishtina

KB Bashkimi e ka bërë një goditje të madhe për pjesën e dytë të sezonit në Superligën e basketbollit. Klubi prizrenas ka njoftuar se e ka transferuar basketbollistin e deridjeshëm të Sigal Prishtinës, Lejson Zeqiri. "Lejson Zeqiri transferi i radhës", ka shkruar klubi prizrenas. Basketbollisti shqiptar do t'i mbrojë ngjyrat e Bashkimit deri në fund të sezonit, ndërsa ai luan në pozitën e alo-qendrës. Me Zeqirin dhe me përforcimet e tjera, Bashkimi synon të ketë paraqitje më të mira në pjesën e dytë të sezonit 2023/24, derisa aktualisht e sheh veten në vendin e gjashtë.

Renditja e FIFA-s, Kosova dhe Shqipëria në këto pozita e mbyllin vitin

FIFA ka publikuar ranglistën e re, ku Përfaqësuesja e Kosova ka mbetur në pozitën e njëjtë nga muaji nëntor, ashtu sikurse edhe Kombëtarja e Shqipërisë. Argjentina vazhdon kryesimin, e ndjekur nga Franca e dyta, Anglia e treta, Belgjika e katërta dhe Brazili i pesti, pasi ka rënë për dy pozita. Pas tyre vjen Holanda e gjashta duke u ngritur një pozitë, Portugalia bie e shtata, Spanja mbetet e teta, ashtu sikurse Italia e nënta dhe Kroacia që mbyll dhjetëshen. Kosova e mbyll vitin 2023 zë pozitën e 101-të, duke pasur 1202.77 pikë në renditje. Ashtu sikurse Kosova, edhe Shqipëria ka vazhduar në pozitën e njëjtë të cilën e kishte në muajin nëntor. Shqipëria e mbyll këtë vit të suksesshëm në pozitën e 62-të me një total prej 1382.69 pikësh.

Gjyqtarët e futsalit, Besar Beqiri e Besart Ismajli, avancojnë në kategorinë e parë të UEFA-s

Dy gjyqtarët e njohur të Kosovës të Futsalit, Besar Beqiri dhe Besart Ismajli, kanë shënuar një rrugëtim të suksesshëm duke avancuar në kategorizimin e UEFA-s. Ata tani janë avancuar në kategorinë e parë falë paraqitjeve të tyre në arenën ndërkombëtare. Historia e tyre ndërkombëtare nisi kur Kosova u pranua në UEFA në vitin 2016. Në fillim ata ishin në kategorinë e tretë, por duke treguar potencialin dhe përkushtimin ndaj referimit arritën të avancojnë në kategorinë e dytë. Me kalimin e kohës dhe përvojën e zgjeruar, Beqiri dhe Ismajli arritën ta marrin vlerësimin e merituar dhe të bëhen pjesë e kategorisë së parë të gjyqtarëve në UEFA. Kjo kategori është vetëm një hap larg nivelit elitare të UEFA-s dhe tregon jo vetëm profesionalizmin e tyre, por edhe cilësinë dhe aftësinë për të drejtuar me sukses ndeshje të rëndësishme. Kjo arritje e Beqirit dhe Ismajlit nuk është vetëm një sukses personal, por edhe frymëzim për të gjithë gjyqtarët e rinj në Kosovë.

Lojtarët dalin kundër trajnerit, Dortmundi mendon shkarkimin

DORTMUND, 21 DHJETOR - Pavarësisht prej kualifikimit në fazën tjetër të Ligës së Kampionëve, skuadra e Borussia Dortmundit po kalon një çast mjaft delikat në kampionat. Skuadra e drejtuar nga trajneri Edin Terziq ndodhet në vendin e pestë në Bundesliga, 12 pikë larg kreut (madje me një ndeshje më

shumë krahasuar me Leverkusenin). Në katër javët e fundit Dortmundi ka korrur vetëm tri pikë, duke bërë që situata brenda grupit të jetë e tensionuar. Kjo situatë mund t'i kushtojë trajnerit Terziq, që sezonin e kaluar humbi titullin kampion në sekondat e fundit të javës së fundit të kampionatit.

Sipas "Bild"-it, lojtarët janë duke ngritur krye ndaj trajnerit, duke nisur një revoltë në dhomat e zhveshjes. Dhe në krye të revoltës është Marco Reus, kapiteni i shumë betejave, i cili nuk është i kënaqur me trajtimin e marrë. Gjithçka ka nisur pas zëvendësimit që Terziq i bëri Reus në minutën e 58 të

ndeshjes ndaj Augsburgut. Reus ka dalë nga fusha pa e përshëndetur dhe folur me trajnerin, duke u ulur në stol i mërzitur. Ky veprim nuk ka lënë pa u ndëshkuar nga trajneri Terziq, që dje e la lojtarin për 90 minuta në stol dhe në sfidën e ardhshme mund të përfundojë në tribunë. Situata duket e



tensionuar, aq sa klubi mund të ndërhyjë për ta zgjidhur mosmarrëveshjen, madje mund ta shkarkojë trajnerin.

Gjykata Evropiane e Drejtësisë vendos në favor të Superligës

Nyon, 21 dhjetor - Gjykata Evropiane e Drejtësisë ka mbajtur të enjten seancën gjyqësore për padinë e ngritur nga Superliga në lidhje me sundimin e UEFA dhe FIFA në botën e futbollit në kundërshtim me ligjet. Gjykata e Drejtësisë së Bashkimit Evropian, në fakt, vendosi në favor të Superligës, e cila kishte apeluar monopolin nga UEFA dhe FIFA. Sipas GJED-së, në fakt, ka një abuzim me pushtetin dominues nga dy organet më të larta të futbollit kontinental dhe botëror, të cilat ushtrojnë monopol. Gjykata ka vënë në dukje gjatë seancës se ka abuzim të dukshëm të pushtetit dominues nga UEFA dhe FIFA duke ushtruar monopol. Sipas gjykatës në fjalë, UEFA nuk mund të ushtrojë monopol dhe do të ishte e ligjshme të krijohet një garë paralele e menaxhuar nga klubet. Vendimi shton gjithashtu se garat e futbollit dhe shfrytëzimi i medias janë aktivitete të dukshme ekonomike dhe duhet të jenë në përputhje me rregullat e konkurrencës dhe të respektojnë lirinë e lëvizjes, megjithëse aktiviteti ekonomik i sportit ka disa karakteristika specifike, siç është ekzistenca e shoqatave që kanë disa kompetenca rregullatorë dhe kontrolluese dhe fuqi për të



vendosur sanksione. Pas vendimit ka reaguar edhe UEFA. "Ky vendim nuk nënkupton miratimin ose vërtetimin e të ashtuquajturës 'Superligë', por përkundrazi thekson një mangësi historike në para-autorizimin e UEFA-s, një aspekt teknik që tashmë është njohur dhe trajtuar në qershor 2022. UEFA ka besim në qëndrueshmërinë e rregullave të saj të reja, dhe veçanërisht se ato janë në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret përkatëse evropiane. UEFA mbetet e palëkundur në angazhimin e saj për të mbështetur piramidën evropiane të futbollit, duke siguruar që ajo të vazhdojë t'i

shërbejë interesave më të gjera të shoqërisë", thuhet në reagimin e UEFA-s. Kjo e fundit është zotuar se do të vazhdojmë të formësojmë modelin evropian të sportit kolektivisht me shoqatat kombëtare, ligat, klubet, tifozët, lojtarët, trajnerët, institucionet evropiane, qeveritë dhe partnerët. "Ne besojmë se piramida evropiane e futbollit e bazuar në solidaritet, të cilën tifozët dhe të gjithë palët e interesuara e kanë shpallur si modelin e tyre të pazëvendësueshëm, do të mbrohet nga kërcënimi i evazionit nga ligjet evropiane dhe kombëtare", thuhet me tej në reagimin e UEFA-s.

Lakersat në krizë, Philadelphia fluturon me Embiid, triumfojnë Bostoni dhe Denveri

PHILADELPHIA, 21 DHJETOR - Humbja e tretë radhazi për ekipin e Lakersave, që hyn në një krizë pas disfatës në fushën e Chicagos, me shifrat me rezultat 124-108. Tetë lojtarë të Chicagos realizuan mbi 10 pikë, ku u dallua DeRozan me 27 pikë, më i miri në fushë. Rikthehet te fitorja Miami, që mundi 115-106 Orlandon, ndeshje ku u dallua Tyler Herro me 28 pikë. Ekipi i Philadelphia, falë 51 pikëve e 12 reboundeve të Joel Embiidit, mundi me rezultat 127-113 Minnesotan, dy ekipe që pretendojnë në konferencat përkatëse. Jashtë fushe fiton edhe skuadra kampione e Denveri, që mundi me rezultat 113-



104 Toronto. Për Denverin u dallua Nikola Jokic, autor i 31 pikëve dhe 15 reboundeve. Fitore të rëndësishme arriti skuadra e Bostonit, që mundi me rezultat 144-118 Sacramenton. Pesë lojtarë të Celticsit realizuan mbi 20 pikë (Brown e White nga 28 pikë secili).

REZULTAT

Cleveland - Utah Jazz	124-116
Indiana - Charlotte	144-113
Orlando - Miami	106-115
Philadelphia - Minnesota	127-113
Brooklyn - New York	102-121
Toronto - Denver	104-113
Chicago - Lakers	124-108
Houston - Atlanta	127-134
Dallas - Clippers	111-120
Sacramento - Boston	119-144

Pas një ndeshjeje spektakolare, ekipi i Atlantias fitoi 134-127 në fushën e Houstonit. Young me 30 pikë ishte shënuesi më i mirë për miqtë.

SHKURT

Inzaghi pas eliminimit nga Kupa: Jemi të zhgënjyer

Bologna ka eliminuar Interin nga Kupa e Italisë, duke e mposhtur me përmbysje, të mërkurën mbrëma. Bologna fitoi me rezultat 2-1, me dy gola të shënuara në vazhdimë. "Ka shumë zhgënjim. E drejtuam në ndeshjen dhe, qartësisht, e meritonim fitoren, por futbollit është i tillë. Do të na shërbejë si leksion. Nuk ishim mësuar të na përmbysnin. Djemtë nuk janë të lumtur pas një ndeshjeje të shkëlqyer para tifozëve tanë. Dëshirojam çerekfinalet, por nuk i arritëm", ka thënë Inzaghi. Kësisoj, Rossoblu do të përballlet me Fiorentinën në çerekfinale muajin e ardhshëm dhe Interi do të largohet pas fitimit të këtij trofeu dy vjet radhazi. Pavarësisht se Interi pati një penallti, koha e rregullt përfundoi pa gola. Interi mori epërsinë në fillim të kohës shtesë me anë të Carlos Augusto, por gola nga Sam Beukema dhe Dan Ndoye ia dhanë fitoren Bolognas.

Arteta kërkon katër përforcime në janar

Trajneri i Arsenalit, Mikel Arteta, i ka kërkuar klubit të bëjë katër përforcime cilësore në merkaton e janarit në mënyrë që "topçinjtë" t'i arrijnë objektivat e dëshiruara. Skuadra londineze kryeson në Premierë Ligë dhe është kualifikuar në raundin tjetër të Ligës së Kampionëve. Për këtë arsye, Arteta kërkon përforcime të rëndësishme, në mënyrë që të ruhet i njëjti standard deri në fund të sezonit, kur vështirësia bëhet më e madhe. Sipas "The Independent", vëmendja më e madhe është te sulmi, ku Arteta kërkon ta sjellë në Londër sulmuesin Ivan Toney, që për momentin është i pezulluar deri në janar. Arteta kërkon përforcime edhe në mesfushë e mbrojtje për ta evituar ndonjë problem që mund të lindë nga lëndimet.

Xavi: Lojtarët duhet ta japin shpirtin në fushë

Trajneri i Barcelonës, Xavi Hernandez, pas fitores mjaft të vështirë ndaj Almerisë (3-2), ka thënë se lojtarët duhet që, për respekt të klubit, ta japin shpirtin në fushë, gjë të cilën nuk e bënë në pjesën e parë të kësaj ndeshje. "Pjesa e parë ishte e papranueshme, presioni dhe agresiviteti i ekipit ishte i papranueshëm. Duhet të vrapojmë si kafshë, të jemi të bashkuar, ta japim shpirtin në fushë, në të kundërt nuk arrijmë asgjë. Nuk jemi Barcelona e 2010-s por, të paktën, vitin e shkuar ishim agresivë dhe kishim shpirt. I kuptoj tifozët që vërsellejnë. Lojtarët, për respekt të shoqërisë, duhet të japin shpirtin në fushë, gjë që nuk e bënë në pjesën e parë", u shpreh Xavi. Barcelona aktualisht është në pozitën e tretë me 38 pikë, gjashtë pikë më pak se Girona e vendit të parë.

Përmbysjet autobusi, humb jetën portieri 25-vjeçar

Zakaria Bouziani, portier 25-vjeçar i Mouloudia d'El Bayadh, një klub algerian i Ligës 1, humbi jetën së bashku me ndihmëstrajnerin Khaled Zitouni pas përmbysjes së

autobusit që transportonte ekipin në provincën e Tiaret, Algeria Veri Perëndimore. Këtë e ka bërë me dije televizioni shtetëror, duke cituar Drejtorinë e Mbrojtjes Civile

të Tiaret, duke saktësuar se nga aksidenti janë lënduar edhe tetë persona. Autobusi i ekipit po udhëtonte për në provincën bregdetare të Tizi Ouzou për

ndeshjen e mbrëmjes së të premtes kundër Js Kabylie, e vlefshme për javën e njëmbëdhjetë të kampionatit algerian. Sipas të njëjtit burim,

Federata Algeriane e Futbollit ka vendosur t'i shtyjë ndeshjet e kampionatit kombëtar të të gjitha divizioneve të planifikuara për në fund të kësaj jave.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "Vizion" L.L.C. ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 810102533 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Vizion" L.L.C. donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810102533 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability "Vizion" L.L.C. has come to the decision to quit its business: 810102533 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement-publication.

MSC. ALBULENA MUSTAFA-ZATRIQI MBRON
PUNIMIN E DOKTORATËS

Njoftohen të gjithë të interesuarit se me datën 27.12.2023 në ora 15:30, në sallën e Profesorëve të **Fakultetit Ekonomik**, MSc. Albulena Mustafa-Zatriqi mbron punimin e doktoratës, me titull: "Menaxhimi i pasurive dhe detyrimeve në funksion të rritjes së performancës së qëndrueshme në bankat komerciale në Kosovë".

Mentor i kandidatës dhe punimit të doktoratës është Prof. Dr. Skender Ahmeti.

Mbrojtja e punimit të doktoratës do të bëhet para komisionit profesional, në përbërje nga :

1. **Prof. Dr. Nexhmie Berisha-Vokshi** - kryetare e komisionit (Fakulteti Ekonomik, Universiteti i Prishtinës)
2. **Prof. Dr. Albulena Shala** – anëtare e komisionit (Fakulteti Ekonomik, Universiteti i Prishtinës)
3. **Prof. Dr. Shiret Elezi** – anëtare e jashtme e komisionit (Fakulteti Ekonomik, Universiteti i Tetovës)

Prishtinë, dhjetor 2023



Kompania Regjionale e Mbeturinave "Ambienti" Sh.A. Pejë

Me adresë Rr.Xhem Sadrija pn ,Fusha e Pejës-Tranzit KK Pejë

Bazuar në ligjin e Punës: LIGJI Nr. 03/L-212 sipas neni 8,dhe në bazë të Udhzimit Administrativ Nr. 07 / 2017, Kryeshefi Ekzekutiv i Kompanis Regjionale të Mbeturinave "Ambienti" Sh.A. Pejë me datë 21.12.2023, shpall konkurs të jashtëm për këtë vende të punës :

KONKURS

Pozita : INKASANT , në Njësia Klinë

Kohëzgjatja e periudhës provuese është 6 muaj me mundësi vazhdimi sipas kontratave të ligjit të punës.

Ka këto detyra dhe përgjegjësi

1. Bëni inkasimit nga shfrytëzuesit e shërbimeve dhe ngarkohet materialisht me fatura sipas rrugëve dhe reoneve
- 2.Për çdo ditë dorëzon pazarin ditor dhe ngarkohet me fatura.
- 3.Plotëson fletë dorëzimin mbi kryerjen e pagesave me shënimet e duhura.
- 4.Përcjell gjendjen në teren për zbulimin e sipërfaqeve në sektorin private dhe
5. bënë evidencën,e tyre dhe me shkrim e informon shefin e shërbimit.
- 6.Është i obliguar që të përcjellë ndërrimin e pronarit të banesave, shtëpive dhe të merr shënimet të cilat i dorëzon shërbimit komercialo-financiar.
- 7.Është i obliguar që për çdo parregullsi në fatura, t'i kthejë në rilogaritje.
- 8.Obligohet që në teren të sillt korrekt dhe të mban uniform apo shenjë identifikimi të Ndërmarrjes.
- 9.Kryen edhe punë tjera me urdhëres të Shefit të inkasantëve, Përgjegjësit Financiar dhe Kryeshefit Ekzekutiv
- 10.Për punën e vetë i përgjigjet drjtëpërdrejt Kryeshefit Ekzekutiv.

Kushtet:

- Shkolla e mesme ekonomike
- Ai /Ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën presion, të ketë moral të fortë për punë dhe integritet të nivelit të lartë;
- Njohuri për punë në kompjuter (MS Word, Excel etj.);
- 1 vite përvojë pune

Mënyra e Aplikimit: Aplikacioni merret dhe dorëzohet në ndërtesën e Ndërmarrjes "Ambienti" SH.A Rr Xhem Sadrija pn në Pejë. Dokumentacioni duhet të dorëzohet në pliko të mbyllur në të cilin duhet të shkruhet pozita për të cilën aplikon. Data e fundit për aplikim është më: 12.01.2024 ora 12:00. Dokumentacioni që mbërrin pas afatit dhe i pakompletuar do të konsiderohet i pavlefshëm. Dokumentet duhet të dorëzohen vetëm në kopje pasi të njëjtat nuk ju kthehen. Dokumentet origjinale mund të kërkohen, sipas nevojës. Vetëm kandidatët e selektuar për listën e ngushtë do të kontaktohen

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Feride Maxhuni, shpall te pavlefshme 3 dëftesat e shkollës se mesme "Xheladin Deda".

- Jahir Hodaj, shpall te pavlefshme dëftesa e klasës 6,7,8 shkolla fillore "Migjeni", Mitrovicë.

- Jahir Hodaj, shpall te pavlefshme dëftesat e shkollës fillore klasa 1,2,3,4,5 -shkolla "Bajram Curri" Prizren.

- Razita Kajtazi, shpall te pavlefshme diplomën e shkollës se mesme "Xheladin Deda".

- Sadik Sahiti, shpall te pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Harun Beka".

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049/44-888-801 (viber)



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
 Qeveria –Vlada-Government
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCES DHE TEKNOLOGJISË
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRRITUR
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
 AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr. 1668/23
 Dt. 20.12.2023

KONKURS

**PËR REGJISTRIMIN E NXËNËSVE PËR VITIN SHKOLLOR 2023/2024,
 KLASËT E 10-ta PËR VIJUES NË ARSIMIN E MESEM TË LARTË
 PROFESIONAL –
 MESIMI PËR TË RRRITUR**

Për plotësimin e vendeve të lira për regjistrimin e nxënësve në klasën e dhjetë (10) në Q.K. "11 Marsi" në Prizren, **shpallim këto drejtime:**

I. Makineri			
1	Instalues i Ngrohjes, Klimatizimit dhe Ujësjetës	1 Paralele	24 nxënës
2	Automekanik	1 Paralele	24 nxënës
3	Dizajn i Metaleve	1 Paralele	24 nxënës
II. Ndërtimtari			
1	Arkitekturë	1 Paralele	24 nxënës
2	Ndërtimtari	1 Paralele	24 nxënës
3	Dizajn Enterier	1 Paralele	24 nxënës
III. Artet e aplikuara			
1	Dizajn Veshje	1 Paralele	24 nxënës
2	Dizajn Grafik	1 Paralele	24 nxënës
IV. TRANSPORT			
1	Transport Rrugor	1 Paralele	24 nxënës
V. Elektroteknikë			
1	TIT	1 Paralele	24 nxënës
2	Informatikë	1 Paralele	24 nxënës
3	Instalues Elektrik	1 Paralele	24 nxënës
4	Teknik i sistemeve të IT (TSIT)	1 Paralele	24 nxënës

1. Kushtet e përgjithshme për regjistrimin e nxënësve të rregullt

Për regjistrimin e nxënësve në klasën e 10-të, për vijimin e mësimin për të rritur në shkolla profesionale, për vitin shkollor 2023/2024, mund të konkurrojnë kandidatët të cilët e kanë mbaruar arsimin e obligueshëm dhe që janë më të vjetër se 17 vjeç.

Nxënësit, të cilët e kanë mbaruar klasën e 9-të jashtë Kosovës, obligohen ta bëjnë nostrifikimin e dëftesave në MASHT dhe pastaj të konkurrojnë për regjistrim.

2. Dokumentet e nevojshme për konkurrim

Nxënësit për të konkurruar për regjistrim në klasën e 10-të shkollave profesionale, duhet të paraqesin këto dokumente:

Fletëparaqitjen (e cila merret në shkollën në të cilën konkurron)
 Dëftesën origjinale për kryerjen e shkollës së mesme të ulët (6-9) dhe Certifikatën e lindjes.

1. Afati i paraqitjes së dokumenteve dhe shpallja e rezultateve

Paraqitja e dokumenteve, bëhet 15 ditë nga dita e shpalljes. Dorëzimi i dokumenteve bëhet në lokalet e shkollës Q.K. "11 Marsi" në Prizren, nga ora 10:00-14:00.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
OIK

Oda e infermierëve, mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësor të Kosovës
Komora medicinskih sestara, babica i ostalih zdravstvenih stručnjaka Kosova
The Kosovo Chamber of nurses, midwives and other health professional



Në bazë të nenit 8 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, Udhëzimit Administrativ Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave për Themelimin e Marrëdhënies së Punës në Sektorin Publik. Në bazë të nenit 20 pika 1.6 të Ligjit për Odat e Profesionistëve Shëndetësor Nr.04/L-150, nenit 23 pika 1.6 të Statutit të OIK-ut, vendimit të Këshillit Drejtues me Nr.Prot.1668 të datës 08.12.2023 dhe mbështetur në Rregulloren Organizimi i Shërbimit Profesional Administrativ të OIK-ut, OIK shpallë këtë:

KONKURS

Për këto pozita të punës:

Titulli i vendit të punës: Udhëheqëse për Licencim, Ri licencim të Psikologëve Klinik,

Logopedëve, Ergoterapistëve

Norma e punës: Orar i plotë (40 orë pune në javë)
Kontrata: Sipas legjislacionit në fuqi
Raporton: Kryetares të OIK-ut
Nr. i zyrtarëve: Një (1) Pozitë.

Përshkrimi i detyrave të punës:

- Kordinon punën e zyrës;
- Mbikëqyrë në baza ditore realizimin e punëve të zyrës;
- Asiston dhe jep ndihmë komisioneve përkatëse për licencim të psikologut klinik;
- Harton planin e punës;
- Përgadit raportet mujore, tremujore dhe vjetore të zyrës;
- Inicon te organet e odës propozimet për ndryshimin dhe plotësimin e akteve normative për licencim dhe rilicencim të psikologut klinik;
- Bashkëpunon me njësit tjera organizative të shërbimit profesional dhe administrativ në çështjet e veprimeve të lidhura me procedurat e licencimit të psikologut klinik;
- Kujdeset për mirmbajtjen e librave të anëtarëve të Odës, licencimit, rilicencimit të psikologëve klinik.
- Përgadit dhe nxjerrë aktet e miratuara në Komisionin për licencim;
- Mban evidencë për pjesëmarrje në takimet e Komisioneve dhe i procedon ato në njësitë përkatëse tjera organizative të Odës;
- Kryen dhe punë tjera sipas kërkesës së Kryetares;
- Është përgjegjës për mbarëvajtjen e punës së zyrës;
- Kujdeset për ligjshmërinë e punës së Zyrës;
- Ngrit çështjet e nevojës së draftimit të akteve normative në lëmitë që i përkasin fushës së përgjegjësisë të zyrës;

Shkollimi i kërkuar:

- ✓ Fakulteti i Psikologjisë, Licencën e Psikologut Klinik
- ✓ 2 vite përvojë punë

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

- ✓ Diploma e Fakultetit Universitar
- ✓ Licenca Valide e Psikologut Klinik
- ✓ Dokumenti i identifikimit (Letër-ndaloimi) kopje.
- ✓ Dëshmi për përvojën e punës.

Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, si dhe të ketë aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave.

Procedurat e konkurimit: Konkurrimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar.

Data e mbylljes së konkursit: 15 ditë nga data e publikimit në mjetet e informimit.

Paraqitja e kërkesave: Aplikacionet merren, plotësohet, dhe dorëzohen çdo ditë pune nga ora 09:00-14:00 në zyrat e OIK-ut.

Adresa: Rruga "Holger Pedersen" mbraja QKUK-së kompleksi banesor Vëllezërit Asllani.

Të gjitha dokumentet dhe dëshmitë profesionale t'i bashkëngjiten aplikacionit.

Aplikacionet e dërguara pas datës së mbylljes së konkursit dhe kërkesat e pa kompletuara nuk do të pranohen.

Kandidatët të cilët aplikojnë, të ofrojnë dëshmitë sipas konkursit të shpallur, për ndryshe kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e konkursit nuk do të thirren për intervistim.

Prishtinë,
 Datë: 22.12.2023

